



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “GJUHË ANGLEZE” ARSIMI FILLOR KLASA 1

FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinatore: Ludmilla Stefani

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË ANGLEZE” (KLASA I)

1	HYRJE	4
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	5
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	7
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA	9
4.1	Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit	9
4.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjuhës angleze.....	13
4.3	Kompetencat e lëndës së gjuhës angleze dhe rezultatet e të nxënit	15
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	19
5.1	Koha mësimore për klasën e parë	19
5.2	Përmbajtja e klasës së parë	20
5.3	Veprimtari gjuhësore	25
5.4	Strategji komunikimi	35
5.5	Kompetenca shumë gjuhësore dhe shumë kulturore	36
5.6	Qëndrime dhe vlera	37
5.7	Formimi kulturor dhe ndërkulturor	38
5.8	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN)	39
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	42

6.1	Qasja e orientuar drejt veprimit (Action-oriented approach).....	42
6.2	Roli i situatave praktike në lëndën e gjuhës angleze	46
6.3	Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës angleze	46
6.4	Pedagogjia e mësimdhënies së gjuhës angleze në moshë të hershme	48
6.5	Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	52
6.6	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjuhës angleze.....	53
6.7	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës angleze.....	54
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	55
7.1	Llojet e vlerësimit në lëndën e gjuhës angleze	55
7.2	Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e gjuhës angleze	57
7.3	Teknika për vlerësimin formues	57
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	60
8.1	Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore.....	60
9	ANALIZA SASIORE E PROGRAMIT TË GJUHËS ANGLEZE NË KLASË TË PARË	62
10	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT.....	64
11	NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE	68
12	TABELA E NIVELEVE SIPAS KLASAVE.....	69

1 HYRJE

Programi i gjuhës angleze për klasën e parë ka për qëllim të nxisë interesin dhe dashurinë e fëmijëve ndaj gjuhës së huaj përmes aktiviteteve të thjeshta, lojërave, këngëve dhe komunikimit të përditshëm. Fokusi kryesor i mësimi të gjuhës angleze në moshë të hershme është ndërtimi i një baze të fortë për të kuptuar dhe përdorur fjalë dhe shprehje të thjeshta në situata nga jeta e përditshme. Mësimi zhvillohet në mënyrë të natyrshme dhe të këndshme, duke respektuar individualitetin e çdo fëmije dhe duke krijuar një mjedis të sigurt e inkurajues për të folur dhe dëgjuar gjuhën angleze.

Programi i gjuhës angleze për klasën e parë është i ndërlidhur ngushtë me lëndët e tjera, si matematika, gjuha shqipe, dituria e natyrës, teknologjia, etj. Aftësitë e fituara në gjuhën angleze krijojnë mundësi për nxënësit të aplikojnë njohuritë e marra në situata praktike të jetës në klasë, shkollë familje dhe komunitet. Kjo lidhje e fortë e gjuhës angleze me lëndët e tjera ndihmon nxënësit të shohin rëndësinë e gjuhës angleze në kontekstin e një arsimimi të gjithanshëm.

Programi i gjuhës angleze është hartuar për të përmbushur nevojat e çdo nxënësi, duke ofruar përmbajtje të pasur, aktivitete krijuese dhe përdorim të teknologjisë së informacionit. Qasja e orientuar drejt veprimit dhe angazhimit në projekte nga jeta reale janë faktorë të rëndësishëm që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rolin e gjuhës angleze si pjesë e botës moderne dhe të zhvillojnë besimin në aftësitë e tyre.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Programi i gjuhës angleze për klasën e I është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe Volumit Shoqërues dhe promovon shumë gjuhësinë, ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e diversitetit gjuhësor dhe kulturor. Qëllimi kryesor i mësimit të gjuhës angleze në arsimin fillor është të formojë dhe të nxisë te nxënësit zhvillimin e aftësive të para komunikuese në gjuhën angleze përmes metodave të përshtatshme për moshën, duke ndërtuar një bazë të thjeshtë por të qëndrueshme në të kuptuarit dhe përdorimin e gjuhës në mënyrë të natyrshme dhe të këndshme.

Programi i gjuhës angleze për klasën e parë thekson rëndësinë e zhvillimit të aftësive të të dëgjuarit dhe të të folurit si bazë e të nxënit të hershëm të gjuhës së huaj. Mësuesi duhet të përqendrohet më shumë në krijimin e një mjedisi të sigurt e motivues, ku fëmijët mësojnë përmes lojërave, këngëve, vjershave dhe aktiviteteve argëtuese, duke shmangur përqendrimin e tepërt tek gramatika, të shkruarit dhe të lexuarit. Qëllimi është që nxënësit të ndihen të sigurt në përdorimin e gjuhës angleze të folur dhe të zhvillojnë një qëndrim pozitiv ndaj saj që në hapat e parë të të nxënit.

Programi synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësim nxënies dhe vlerësimit me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimit dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grup moshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e fuqizuar atë të jetë i pavarur, krijues, i motivuar dhe i gatshëm për tu përballur me sfidat e së ardhmes dhe të nxënit gjatë gjithë jetës. Është e rëndësishme që fëmijëve t'u jepen mundësitë për të përvetësuar gjuhën angleze që në fazat e hershme të zhvillimit të tyre. Mësimi i gjuhës ndërtohet mbi qëndrime dhe sjellje pozitive, bashkëveprim dhe aftësi krijuese.

Nxënësi në klasën e I fillon nivelin gjuhësor Pre A1, i cili përmbillet në fund të klasës së dytë.

Tabela 1. Përshkrimi i nivelit Pre A1 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët

Pre A1	Young learners at grade I are identified as Pre-A1 language users who are gradually introduced to English language and culture. Pre-A1 represents a ‘milestone’ half way towards Level A1, a band of proficiency at which the learner has not yet acquired a generative capacity, but relies upon a repertoire of words and a set of expressions.
---------------	---

Programi synon të zhvillojë tek nxënësi një sërë aftësish të transferueshme për të kuptuar dhe komunikuar në situata të përditshme në gjuhën angleze. Nxënësi forcon jo vetëm vetëdijen kulturore për vendet dhe popujt që flasin gjuhën angleze, por edhe aftësitë gjuhësore të nevojshme që do ta ndihmojnë atë për të studiuar ose për t’u punësuar në të ardhmen.

Objektivat specifike të programit të gjuhës angleze për klasën e parë synojnë që nxënësit të:

- formojnë një qëndrim pozitiv dhe të sigurt ndaj të mësuarit të një gjuhe të huaj;
- dëgjojnë dhe të kuptojnë fjalë dhe shprehje të thjeshta në gjuhën angleze;
- përdorin fjalë dhe fraza të zakonshme për të përshëndetur, prezantuar veten dhe për të ndërvepruar në situata të njohura;
- zhvillojnë aftësinë për të ndjekur udhëzime të thjeshta në gjuhën angleze;
- dallojnë dhe të riprodhojnë tingujt bazë të gjuhës angleze përmes imitimit dhe lojës;
- këndojnë, recitojnë, tregojnë dhe luajnë për të përforcuar fjalorin dhe strukturat e mësuara;
- mësojnë në mënyrë bashkëpunuese, përmes aktiviteteve dhe lojërave që nxisin imagjinatën, krijimtarinë, të menduarin kritik, komunikimin dhe ndërveprimin.




3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Tematikat në këtë program do të jenë të shumëllojshme (jeta personale e shoqërore, jeta në shkollë e në punë, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.). Zotërimi i mirë i gjuhës angleze ndihmon në zgjerimin e dijeve në fusha të tjera. Përvetësimi i gjuhës angleze kontribuon jo vetëm në krijimin e individualitetit të nxënësit por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike që i shërbejnë atij dhe komunitetit.

Programi i lëndës së gjuhës angleze në arsimin fillor përmban:

- *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit që zhvillohen nëpërmjet lëndës së gjuhës angleze.* Lënda e gjuhës angleze kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin e kompetencave kyçe të nxënësit, duke përmirësuar aftësi si komunikimi, mendimi kritik dhe kreativiteti. Mësimi i gjuhës angleze i ndihmon nxënësit të shprehin idetë e tyre qartë dhe të kuptojnë këndvështrime të ndryshme. Nëpërmjet lojërave, punës në grup dhe projekteve, ata zhvillojnë dhe forcojnë aftësi sociale dhe emocionale. Gjuha angleze jo vetëm që mbështet procesin e të nxënit, por gjithashtu përgatit nxënësit për sfidat e së ardhmes.
- *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së gjuhës angleze.* Programi i gjuhës angleze ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet gjuhësore me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të gjuhës angleze



- *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënësve.* Lënda e gjuhës angleze synon të pajisë nxënësit me kompetenca që shkojnë përtej njohjes së rregullave gramatikore, duke ju mundësuar atyre të kuptojnë dhe të përdorin gjuhën në mënyrë të saktë dhe të komunikojnë natyrshëm dhe qartë në situata reale. Ky proces i ndihmon nxënësit të kuptojnë kontekstin kulturor dhe shoqëror të komunikimit dhe i përgatit ata për të përballuar sfidat e së ardhmes në një botë që është gjithmonë në ndryshim.

- *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënësve.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) në varësi të klasës dhe nivelit gjuhësor, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup dhe për projekte; veprimtaritë që kryen nxënësi për secilën nga mënyrat e përvetësimit të gjuhës dhe strategjitë për realizimin e tyre, aftësitë gjuhësore, dhe qëndrimet që demonstرون

nxënësi. Gjithashtu në këtë rubrikë shpjegohet edhe rëndësia e kompetencës së shumë gjuhësisë dhe shumë kulturave. Në këtë rubrikë do të ketë edhe disa shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve në komunikimin online dhe ndërmjetësimin gjuhësor.

- *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e gjuhës angleze është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave interaktive dhe me në qendër nxënësin, të nxënësve bashkëveprues, mësimdhënies së diferencuar, përdorimit të teknologjisë, të nxënësve nëpërmjet lojërave etj. Gjithashtu në këtë rubrikë shpjegohet pedagogjia e mësimdhënies së gjuhës angleze në moshë të hershme.

- *Vlerësimi i nxënësve është një tjetër rubrikë, e cila përshkruan në mënyrë të përmblëdhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit, vlerësimin si metodologji të nxëni. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të teknikave të ndryshme për vlerësimin formues të nxënësve në klasën e parë.*
- *Burimet dhe materialet didaktike që mund të përdoren në lëndën e gjuhës angleze janë përfshirë në këtë rubrikë. Zbatimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale si mjete ndihmëse trajtohen gjithashtu në program si burime të rëndësishme për zhvillimin e aftësive gjuhësore.*
- *Rekomandime për zbatimin e programit. Në këtë rubrikë do të ketë disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, hartuesit e teksteve mësimore, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit dhe nxënësit.*
- *Ndryshimet përmbajtjesore. Në këtë rubrikë përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore.*

4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyç dhe atyre të lëndës. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç që mund të zhvillojë nxënësi në përfundim të arsimit fillor në lëndën e gjuhës angleze mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 2. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

1	Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - lexon me zë një tekst, deri në 400-500 fjalë, me një temë që i përshtatet moshës; - shkruan një tekst rreth 100-150 fjalë për një temë të caktuar; - paraqet të paktën një mendim për një temë gjatë diskutimit në grup prej 3-5 minutash; - shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë të lexuar, përmes njërës prej formave shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit, luajtjes me role, këngës apo vallëzimit; - identifikon personazhet e një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje që është e përshtatshme për moshën dhe performon me moshatarët e tij; - shpreh me forma të ndryshme mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe e prezanton atë para të tjerëve; - shpreh, për rreth 5 minuta, përpara të tjerëve përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi, shikimit apo një vallëzimi, dëgjimit apo të një kënge, melodie, në njërin nga format shprehëse.
2	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> - kupton fjalë dhe fjali të shkurtra që lidhen me jetën e përditshme (nëse ato shqiptohen ngadalë dhe qartë); - përdor fjalë dhe shprehje që lidhen me të dhëna personale, situata/veprime konkrete; - shqipton saktë një numër fjalësh/shprehjesh të përdorura në jetën e përditshme; - kupton dhe zbaton udhëzime, përsëritje të përsëritura dhe të përdorura në klasë dhe jashtë saj;

	- kopjon fjalë dhe shprehje të shkurtra, të njohura paraprakisht; - pyet dhe përgjigjet me fjali shumë të thjeshta rreth detajeve personale, objekteve dhe veprimeve kryesore që kryhen gjatë ditës; - shkruan një urim të shkurtër, shpreh një dëshirë, ose shkruan fjali të thjeshta për tema të njohura.
3	Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
	<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; - përdor fjalor fillestar të matematikës për t'u shprehur, kur trajton situata matematike; - përdor mjete dhe metoda gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; - demonstroi konceptin e numërimit të figurave, vizatimeve dhe objekteve; - shpreh me mjete konkrete koncepte të thjeshta matematike; - lidh njohuritë matematike me situata të thjeshta nga jeta e përditshme; - përdor mjete të thjeshta për llogaritje dhe matje; - nxjerr përfundimet dhe i paraqet ato; - vëren dhe i shpreh problemet që ndodhin rreth tij; - nën drejtimin e mësuesit, gjen informacion për shkencat natyrore; - sillet në mënyrë të sigurt, ndjek një mënyrë jetese të shëndetshme, sillet me respekt ndaj qenieve të gjalla dhe ndaj nevojave të tyre.
4	Kompetenca digjitale
	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor kompjuterin, tabletën, smartfonin; - njeh veprimtaritë e kodimit duke përdorur platformat digjitale që ka mësuar;

	- përdor aplikacione edukative të krijuara për fëmijët; - bashkëpunon në internet; - është ndërgjegjësuar për sigurinë në internet.
5	Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit
	<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i> - njeh dhe i shpreh rregullat themelore të higjienës personale dhe të mjedisit ku jeton dhe vepron; - merr pjesë në veprimtari fizike dhe lojëra sportive dhe respekton rregullat e caktuara; - liston ushqimet që i konsumon dhe masat për t'u mbrojtur nga sëmundjet; - përdor kohën e lirë në të mirën e shëndetit dhe të mirëqenies së tij; - kujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë një aktiviteti; - zgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat etj., për kryerjen e një detyre dhe tregon si e zgjidhi; - pyet dhe përgjigjet për detyrën që kryen me një nga format e shprehjes; - grumbullon dhe klasifikon materialet e detyrës për përgatitjen apo për pasurimin e portofolit të tij; - kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive që ndesh kur kryen një detyrë apo porosi.
6	Kompetenca qytetare
	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi ku është pjesëmarrës (grup loje, veprimtari); - diskuton me shokët dhe vendosin rregullat për realizimin e veprimtarisë, mirësjelljes, pastërtisë etj.; - njeh dhe identifikon vlerat që kultivohen në klasë, shkollë apo familje; - shpreh mendimin dhe respekton mendimin e shokëve gjatë kryerjes së veprimtarie; - vlerëson elemente të pjesëmarrjes në veprimtari dhe përgjegjësinë vetjake; - përshkruan si mund të sillet në një situatë konflikti.
7	Kompetenca e sipërmarrjes

	<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - përgatit një plan pune të thjeshtë javor dhe cakton veprimtaritë që do të realizojë; - punon dhe ndan ide me të tjerët; - vepron i pavarur dhe tregon përgjegjësi për veprimet e tij; - përgatit një projekt të vogël; - llogarit shpenzimet personale ose familjare për një ditë; - lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimeve, ilaçeve) dhe sqaron rreziqet nga mospërdorimi në mënyrën e duhur; - paraqet në formë vizatimi apo në një formë tjetër përkujdesjen për kafshën që parapëlqen.
8	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh tradita, vlera, zakone dhe shprehje artistike të zonës së tij e më gjerë; - njeh elemente të trashëgimisë sonë kulturore dhe i respekton ato; - shprehet me gojë dhe me shkrim nëpërmjet tregimeve të shkurtra, vizatimeve, pikturave ose interpretimit të vjershave; - është i informuar për kulturat e tjera dhe për diversitetin e tyre; - performon këngë, ritme dhe hapa të thjeshtë kërcimi nga kultura të ndryshme; - njeh histori dhe përralla të ndryshme dhe i ndan ato me të tjerët.

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjuhës angleze

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënit, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij.

Integrimi i temave ndërkurrikulare me gjuhën angleze në arsimin fillor u mundëson nxënësve të aplikojnë njohuritë e tyre gjuhësore në situata të ndryshme nga jeta reale. Kjo i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të menduarit në mënyrë krijuese dhe kritike duke i inkurajuar ata të eksplorojnë më tej botën që i rrethon. Përdorimi i gjuhës angleze si një mjet komunikimi dhe shprehjeje, zhvillon tek nxënësit aftësi të rëndësishme

të cilat ndihmojnë në përshtatjen me tregun e punës dhe jetën e përditshme. Kjo qasje gjithashtu rrit motivimin dhe angazhimin e nxënësve si qytetarë aktivë në shoqëri.

- *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Mësimi i gjuhës angleze u jep fëmijëve mundësinë të njihen me kultura të ndryshme në mënyrë të thjeshtë dhe argëtuese, duke ruajtur lidhjen me kulturën dhe traditat e vendit të tyre. Përmes këngëve, përrallave, figurave historike dhe festave tradicionale të vendeve të ndryshme, nxënësit mësojnë fjalë e shprehje të reja dhe krahasojnë elementë të kulturës së tyre me ato të vendeve të tjera. Këto aktivitete ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë, të kuptojnë dhe të respektojnë diversitetin kulturor, si dhe të forcojnë aftësitë e tyre komunikuese në gjuhën angleze.
- *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Mësimi i gjuhës angleze mbështet zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë dhe bashkëpunimit përmes aktiviteteve të thjeshta, të cilat i ndihmojnë fëmijët të punojnë së bashku, të marrin iniciativa dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Përmes lojërave me role, punës në grupe dhe projekteve të thjeshta, fëmijët përdorin fjalë dhe shprehje në anglisht për të bashkëbiseduar dhe për të zgjidhur situata të përditshme. Këto përvoja ndihmojnë jo vetëm në zhvillimin e aftësive gjuhësore, por edhe në formimin e shprehive të qytetarisë aktive që në moshë të hershme.
- *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.* Mësimi i gjuhës angleze kontribuon në zhvillimin e vetëdijes për shëndetin mendor, fizik dhe sigurinë përmes aktiviteteve të thjeshta dhe argëtuese. Përmes këngëve, lojërave dhe tregimeve të shkurtra, fëmijët mësojnë fjalë dhe fraza të lidhura me ndjenjat e tyre, pjesët e trupit, ushqimet e shëndetshme dhe rregullat e sigurisë. Ata mësojnë shprehje të thjeshta për të treguar si ndihen ("I'm happy", "I'm tired"), çfarë u pëlqen të hanë apo si të kujdesen për veten. Këto aktivitete ndihmojnë në rritjen e vetëdijes, ndërveprimin pozitiv dhe zhvillimin e aftësive komunikuese që mbështesin mirëqenien e tyre të përgjithshme.
- *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Mësimi i gjuhës angleze nxit dashurinë dhe kujdesin për mjedisin përmes fjalëve, këngëve dhe tregimeve të thjeshta. Nxënësit mësojnë fjalor bazë të lidhur me natyrën, kafshët, riciklimin dhe mbrojtjen e mjedisit ("tree", "water", "recycle", "clean"). Mësuesi planifikon aktivitete që përfshijnë biseda të thjeshta si të kujdesemi për natyrën apo lojëra ku identifikohen

veprime miqësore me mjedisin. Këto përvoja ndihmojnë në formimin e sjelljeve të qëndrueshme që në moshë të hershme, ndërsa zhvillojnë edhe aftësitë gjuhësore në mënyrë të natyrshme.

- *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Mësimi i gjuhës angleze në klasën e parë mund të integrohet me përdorimin e teknologjisë në mënyrë të sigurt dhe të kuptueshme për fëmijët. Përmes videove edukative, lojërave gjuhësore digjitale dhe imazheve të thjeshta, nxënësit fillojnë të njihen me rolin e medias dhe teknologjisë në jetën e përditshme. Ata mësojnë fjalë të thjeshta që lidhen me pajisjet teknologjike ("computer", "phone", "TV") dhe zhvillojnë ndërgjegjësim fillestar për përdorimin e tyre të kujdesshëm. Kjo qasje nxit aftësi fillestare në përpunimin e informacionit digjital dhe në komunikimin përmes mjeteve të teknologjisë, duke ruajtur gjithmonë natyrën argëtuese dhe të përshtatur me moshën e fëmijëve.

Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3 Kompetencat e lëndës së gjuhës angleze dhe rezultatet e të nxënit

Bazuar në kurrikulën arsimit fillor, lënda e gjuhës angleze synon të përmbushë 3 kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe arrihen nëpërmjet veprimtarive gjuhësore që kryen nxënësi për përmbushjen e detyrave të caktuara. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë.

Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaj është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, të përdorimit të funksioneve gjuhësore në situata të ndryshme komunikimi dhe lidhjes së tyre me parimet e ligjërimit.




Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së gjuhës angleze

Tabela 3. Kompetencat e lëndës së gjuhës angleze dhe rezultatet e të nxënit për nivelin gjuhësor Pre A1

Competences	Description		Learning outcomes
Linguistic competence	Linguistic competence deals with formal characteristics of a language such as grammar, phonology, morphology, lexicon and syntax. At Pre A1 level the focus is on phonological and phonemic awareness, lexicon, simple expressions and short sentences.	General linguistic range	The young learner: - uses isolated words/signs and basic expressions in order to give simple information about themselves.
		Vocabulary range	No descriptors available
		Grammatical accuracy	- employs very simple principles of word/sign order in short statements.
		Vocabulary control	No descriptors available
		Phonological control	No descriptors available
		Orthographic control	No descriptors available

Sociolinguistic competence	Sociolinguistic competence relates to the socio-cultural dimension of language use such as politeness rules or social group repertoires, expressions of folk wisdom, dialects etc. At Pre A1 level focus is on politeness rules or social group repertoires.	Sociolinguistic appropriateness	- establishes basic social contact by using the simplest everyday polite forms of greetings and farewells; introductions; saying please, thank you, sorry, etc.
Pragmatic competence	Pragmatic competence covers the functional use of language, for example the use in specific structures, communicative structures and scenarios of how to act in a given social event or how to participate in a discussion or interview. At Pre A1 level the focus is on the simple use of communicative structures.	Flexibility	No descriptors available
		Turntaking	No descriptors available
		Thematic development	No descriptors available
		Coherence and cohesion	No descriptors available
		Propositional precision	- communicates very basic information about personal details in a simple way.
		Fluency	- manages very short, isolated, rehearsed utterances using gesture and signalled requests for help when necessary.

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për klasën e parë

Lënda e gjuhës angleze në klasën e parë zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 2 orë secila (45 min), pra gjithsej 70 orë. Programi i gjuhës angleze specifikon peshën (orët e sugjeruara) për secilin komponent mësimor. Shuma e orëve sugjeruese për secilin komponent është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit fillor. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secili komponent në raport me orët totale vjetore.

Tabela 4. Orë të sugjeruara

	Formimi kulturor dhe ndërkulturor	Gramatikë	Formimi gjuhësor	Projekti dhe puna me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
Klasa e I	25 orë	3 orë	35 orë	7 orë	70 orë

Në orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Në orët e formimit gjuhësor mësuesi punon me ushtrime praktike dhe lojëra që përfshijnë koncepte të thjeshta gramatikore si dhe funksione të thjeshta gjuhësore. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përsëritjes, përforcimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Njohuritë

gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke pasur parasysh që përqasja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënit, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit. Mësuesi i gjuhës angleze në klasën e parë nuk shpjegon gramatikë në mënyrë teorike. Mësuesi planifikon veprimtari dhe lojëra ku nxënësi natyrshëm mëson dhe përsërit struktura të thjeshta gramatikore duke u fokusuar tek të folurit dhe të dëgjuarit si dy aftësi që duhet të zhvillohen në klasën e parë.

Planifikimi i orëve të punës me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ) në lëndën e gjuhës angleze ndihmon nxënësin të identifikojnë dhe vlerësojnë arritjet e tij gjuhësore në mënyrë sistematike nëpërmjet një strukture të qartë për zhvillimin e aftësive dhe përmirësimin e kompetencave, dhe e inkurajuar atë të jetë i pavarur në përvetësimin e gjuhës. Mësuesi planifikon veprimtari me PEGJ për ditën Evropiane të gjuhëve të huaja si dhe gjatë orëve të projektit.

5.2 Përmbajtja e klasës së parë

Përqasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit ku nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi.

Përdorimi i gjuhës angleze, duke përfshirë edhe të nxënit e saj, përfshin veprimtari që kryen nxënësi, i cili si individ dhe si pjesëtar i shoqërisë zhvillon kompetencat kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Gjatë këtij procesi, nxënësi përdor kompetencat kyçe në situata dhe kushte të ndryshme, përfshihet në veprimtari gjuhësore të shumëllojshme duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhet të realizojë. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave kyçe. Kjo përqasje ilustron në figurën e mëposhtme.

Diagrama 3. Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës angleze



Njohuri dhe koncepte

Njohuritë dhe konceptet kryesore që trajtohen në lëndën e gjuhës angleze mund të jenë shumë të ndryshme, por për qëllime praktike në lidhje me të nxënit dhe mësimdhënien e gjuhëve, ato mund të klasifikohen gjerësisht në katër fusha kryesore: (a) fusha personale, (b) fusha publike, (c) fusha arsimore -edukative dhe (d) fusha profesionale të cilat ndahen në nën tema.

Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të temave kryesore dhe nën temave, të cilat nuk janë shteruese dhe mund të trajtohen në klasën e parë.

Tabela 5. Fushat tematike dhe rezultatet e të nxënit sipas tematikave

Domains	Topics	Learning outcomes
Everyday life	My world My toys and games	The young learner: - listens to very short dialogues introducing pets, toys, free time activities, etc.; - listens, draws, cuts and sticks numbers;

	My clothes Food Free time activities My pets	- identifies the free time activities that one likes doing with family and friends; - identifies pets, food, toys, activities presented in pictures, very short dialogues or stories; - mimes and guesses the actions as for example running, dancing, playing football/basketball etc.; - listens and sings chants introducing numbers; - identifies food and drink items in a very simple menu; - identifies characters' favourite food items when shown in pictures; - creates a shopping list using pictures; - draws and colours different food as instructed.
School life	My school My class My classmates	The young learner: - identifies the primary colours of and colours the given objects; - listens and repeats the words related to classroom objects; - traces simple words related to school life and classroom objects; - names, points to, draws and colours classroom objects as instructed; - responds to teacher's or classmate's requests, orders or commands by using very simple words or phrases; - listens to, sings songs and repeats the words and very simple phrases of the songs; - matches words to pictures or flashcards related to school and classroom vocabulary.
Personal and social life	Me and others My family My friends	The young learner: - labels some of the body parts in pictures or very short story clips; - listens and repeats the words related to face and body; - chants and sings songs related to body parts;

	My body My house/room	- answers questions related to body parts using very simple word structures; - identifies family members through pictures in short stories; - identifies bedroom/living room objects.
The world around us	My garden Animals Jobs Nature The forest/ park/ beach	The young learners: - identifies and names animals, plants, or parts of a tree shown in pictures or in illustrated in very short stories; - identifies animals shown in pictures or very short stories; - draws and colours animals, plants or shapes as instructed; - answers very simple questions related to animals' abilities; - mimes various animals; - names and distinguishes among professions shown in pictures or in very short stories; - repeats vocabulary related to nature, jobs, and places.
The world of communication	Hello! Introducing friends and siblings Birthday cards	The young learner: - recognizes the greeting words used in very short dialogues, clips and songs; - listens and understands very short dialogues in which the characters introduce and greet each other; - listens and sings greeting songs; - listens and repeats in English the basic greeting words; - wishes friends on their birthday; - sings a birthday song; - asks and answers about his/her age; - uses basic greetings to greet the teacher and peers. - writes birthday cards using pictures and isolated words.

Tabela 6. Njohuritë gramatikore dhe funksionet gjuhësore

Functions	Structures	Examples
Greetings and saying farewell	Formulaic phrases	Hello! Hi! Good morning. Good afternoon. Good night. Good bye. How are you? I am (I'm) fine, thank you.
Responding to basic classroom English	Imperatives (positive)	Look! Listen! Open the door, please! Come here! Be quiet, please! etc.
Giving and asking for personal information	What is ____? How old ____? My/ your _____. Verb: to be I / you + contractions	What is (What's) your name? My name is (name's) _____. What is your surname? My surname is _____. How old are you? I am (I'm) _____ years old.
Identifying things in the classroom	a / an This is ____ Short answers: Yes, it is. / No, it isn't.	What is this? It is a pen, book, ruler, etc. Is it a _____? Yes, it is. / No, it is not (isn't).
Identifying colours.	Adjectives: colours	What colour is this? It is (It's) _____.
Specifying number	How many + plural nouns Numbers	How many <i>books</i> ? Two books.

Asking and talking about ages.	Questions and short answers: Yes, I am. No, I'm not.	Are you <i>five years old</i> ? Yes, I am./ No, I am not. (I'm not)
Identifying friends and members of the family.	Verb: to be S/he + contractions	This is Ben. He is (He's) five years old. He is (He's) my friend. This is Mira. She is (She's) six years old. She is (She's) my sister.
Describing people.	Adjectives / nouns Short answers: Yes/ he is. No, s/he isn't.	Is Ben tall / a doctor/ three years old? Is Mira happy / a teacher?
Expressing possession.	Possessive adjectives: my, your, his, her	This is my book. This is her pen.
Talking about location.	Where? Prepositions of place in, on, under	Where is (Where's) <i>the book</i> ? On the table.

5.3 Veprimtari gjuhësore

Për të përmbushur rezultatet e të nxënit dhe për të forcuar kompetencat e lëndës së gjuhës angleze dhe aftësitë e të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, nxënësi kryen veprimtaritë gjuhësore të mëposhtme:

- a) **Reception activities – Veprimtari marrëse** (të lexuarit, të dëgjuarit)
- b) **Production activities – Veprimtari prodhuese** (të folurit, të shkruarit)

c) **Interaction activities- Veprimtari ndërvepruese** (të folurit, të shkruarit)

d) **Mediation activities – Veprimtari ndërmjetësi** (ndërmjetësi gjuhësor dhe kulturor).

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive gjuhësore dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvete përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pa kontekstualizuar të kompetencave (si p.sh mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi. Përshkrimi i detajuar i veprimtarive të mëposhtme ndihmon mësuesin për të përcaktuar rezultatet e të nxënit për orën mësimore.

a) **Reception activities – Veprimtari marrëse**

Marrja e informacionit përfshin të kuptuarin dhe përpunimin e të dhënave në situata të ndryshme kur nxënësi e dëgjon, e lexon ose e shikon një informacion të caktuar. Si kur dëgjon ashtu edhe kur lexon nxënësi punon për të kuptuar informacionin duke kaluar nga aspektet më të thjeshta drejt përpunimit të informacioneve më komplekse sipas nivelit të kompetencës që synohet. Në klasën e parë sugjerohet që mësuesi fokusin duhet ta vendosë tek të dëgjuarit.

Tabela 7. Veprimtari që zhvillon nxënësi për marrjen e informacionit të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit

RECEPTION ACTIVITIES – PRE A1 LEVEL
<i>Oral comprehension</i>
<i>Overall oral comprehension</i>

The young learner can understand short, very simple questions and statements provided that they are delivered slowly and clearly and accompanied by visuals or manual gestures to support understanding and repeated if necessary; can recognize every day, familiar words, provided that they are delivered clearly and slowly in a clearly defined, familiar, everyday context; can recognise numbers, prices, dates and days of the week, provided that they are delivered slowly and clearly in a defined, familiar, everyday context.

The young learner:

Understanding conversation between other people

- listens and reacts to very simple, familiar greetings and orders;
- understands words related to people who help him/her;

Understanding as a member of a live audience

- understands very simple words about travelling and means of transport;
- understands words related to holidays and festivals during the school year.

Understanding announcements and instructions

- understands and reacts to very simple classrooms instructions provided that they are delivered slowly face-to-face, accompanied by pictures or manual gestures and repeated if necessary; (“Stand up please!”, “Sit down”, “Come in”, “Open your book!”, “Come to the board!”, “Stop!”, “Run!”, “Say”, “Listen”, “Give me the book”, “Take it”, “Wait”, etc.)

Understanding audio (or signed) media and recordings

- recognises words/signs, names and numbers that they already know in simple, short recordings, provided these are delivered very slowly and clearly;
- understands very simple words (f.eg: colours, shapes, clothes, numbers, etc.) in a song or rhyme;

<i>Audio-visual comprehension</i>
<i>Watching TV, film and video</i> - identifies the subject of a video document on the basis of visual information and previous knowledge;
<i>Reading Comprehension</i>
<i>Overall reading comprehension</i>
The young learner can recognise very simple familiar words accompanied by images or pictures, such as school timetable illustrated with photos or a picture book using familiar vocabulary.
The young learner: <i>Reading correspondence</i> - understands from a letter, card or e-mail the event to which they are being invited and the information given about day, time and location; - recognises times and places in very simple notes and text messages from friends provided there are no abbreviations; <i>Reading for orientation</i> - finds information about places, times and prices on posters, flyers and notices; <i>Reading for information and argument</i> - understands the simplest informational material such as a fast-food restaurant menu illustrated with photos or an illustrated story formulated in very simple everyday words/signs; <i>Reading instructions</i>

- understands very short, simple, instructions used in familiar everyday contexts (e.g. “No parking”, “No food or drink”), especially if there are illustrations;
- reads and understands very simple computer or video game instructions;
- understands very simple computer commands;
- reads and understands very simple instructions such as (“Close the door!”, “Switch off/on the light!” etc.)

Reading as a leisure activity

- deduces the meaning of a word from an accompanying picture or icon;
- recognises and reads out very simple familiar words and phrases, e.g., from stories and rhymes;

b) Production activities – Veprimtari prodhuese

Prodhimi i informacionit përfshin detyrat që realizon nxënësi me gojë dhe me shkrim.

Të gjitha detyrat që realizon nxënësi si me shkrim apo me gojë duhet të jenë pjesë e një situatë komunikimi nga jeta reale që justifikon përdorimin e gjuhës angleze.

Tabela 8. Veprimtari që zhvillon nxënësi kur prodhon informacion të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit

ORAL PRODUCTION ACTIVITIES	
<i>Overall oral production</i>	
The young learner can produce very short phrases about themselves, giving basic personal information (e.g., name, address, family, nationality).	

The young learner:

Sustained monologue: describing experience

- describes themselves (e.g. name, age, family), using simple words/signs and formulaic expressions, provided they can prepare in advance;
- expresses how they are feeling using simple adjectives like “happy” or “tired”, accompanied by body language;

Sustained monologue: giving information

- says what his/her name is, how old he/she is, where he/she lives and where he/she goes to school;

WRITTEN PRODUCTION ACTIVITIES

Overall written production

The young learner can give basic personal information (e.g. name, address, nationality), perhaps with the help of the teacher.

The young learner:

Creative writing

- writes very simple greetings in messages and postcards;
- writes short very simple sentences about a familiar topic;
- fills the gaps with words referring to the pictures;
- describes friends, relatives, characters, objects, beloved animals and objects with very short and disconnected words and very simple sentences;
- writes their name, address and age on a very simple form;

c) Interaction activities- Veprimtari ndërvepruese

Nxënësi e mëson dhe e përdor më mirë gjuhën angleze kur ai vendoset në situata ndërveprimi me gojë ose me shkrim dhe shkëmben ide me një ose më shumë bashkëbisedues. Mësuesi i kasës së parë duhet të fillojë së pari me veprimtaritë e të folurit.

Që të jetë efektiv, ndërveprimi duhet t'i afrohet sa më shumë situatave autentike dhe të ngjashme me jetën reale, ku shkëmbimi i informacionit tashmë është një nevojë për secilin nga ne. Ndërveprimi me shkrim po merr gjithnjë e më shumë rëndësi në jetën e përditshme si pasojë e zhvillimit të rrjeteve sociale dhe mjeteve të lëvizshme të komunikimit: e-mail, mesazhe SMS, postime në X, forume diskutimesh, shkrime bashkëpunuese të teksteve online, etj.

Tabela 9. Veprimtari që zhvillon nxënësi kur ndërvepron me të tjerët, të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit

INTERACTION ACTIVITIES
ORAL INTERACTION
<i>Overall oral interaction</i>
The young learner can ask and answer very simple questions about themselves and daily routines, using short, formulaic expressions and relying on gestures to reinforce the information.
The young learner: <i>Understanding an interlocutor</i>

- understands very simple questions that directly concern them (e.g. name, age and address), if the person is asking slowly and clearly;
- understands simple personal information (e.g. name, age, place of residence, origin) when other people introduce themselves slowly and clearly, directly to them, and understands questions on this theme addressed to them, though the questions may need to be repeated;
- understands a number of familiar words/signs and recognise key information (e.g. numbers, prices, dates and days of the week), provided the delivery is very slow, with repetition if necessary;

Conversation

- understands and uses basic, formulaic expressions such as “Yes”, “No”, “Excuse me”, “Please”, “Thank you”, “No thank you”, “Sorry”;
- recognises simple greetings;
- greets people, state their name and take leave in a simple way;

Obtaining goods and services

- makes very simple purchases and/or order food or drink when pointing or other gesture can support the verbal reference;

Information exchange

- tells people their name and ask other people their names;
- uses and understands simple numbers in everyday conversations;
- asks and tell what day, time of day and date it is;
- asks for and gives a date of birth;
- asks for and gives a phone number;
- tells people their age and asks people about their age;
- asks very simple questions for information, such as “What is this?” and understand one- or two-word/ sign answers.

WRITTEN INTERACTION

<i>Overall written interaction</i>
The young learner can convey basic information (e.g. name, address, family) in short phrases on a form or in a note, with the help of the teacher.
The young learner: <i>Correspondence</i> - conveys basic personal information in short phrases and sentences, with reference to a picture dictionary; <i>Notes, messages and forms</i> - fills in very simple registration forms with basic personal details: name, address, nationality, etc.
<i>Online interaction</i>
<i>Online conversation and discussion</i> The young learner: - posts simple online greetings, using basic formulaic expressions and emoticons; - posts online short simple statements about themselves (e.g. nationality, age), provided they can select them from a menu and/or refer to an online translation tool; <i>Goal-oriented online transactions and collaboration</i> - makes selections (e.g. choosing a product, size, colour) in a simple online purchase or application form, provided there is visual support.

d) Mediation activities – Veprimtari ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi gjuhësor sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian për Gjuhët dhe Volumit Shoqërues, ka të bëjë me mënyrën se si nxënësi ja shpjegon një material të cilin ai ka lexuar ose dëgjuar diku që nuk mund ta kuptojë atë material. Ndërmjetësimi gjuhësor përfshin një sërë veprimtarish që variojnë nga perifrazimi e deri te përkthimi. Ndërmjetësimi e vendos nxënësin në një situatë ku ai vlerëson të gjitha njohuritë dhe aftësitë e tij.

Tabela 10. Veprimtari që zhvillon nxënësi gjatë ndërmjetësimit gjuhësor, të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënës

MEDIATION
In mediation, the learner acts as a social agent who creates bridges and helps to construct or convey meaning, sometimes within the same language, sometimes across modalities (e.g. from spoken to signed or vice versa, in cross-modal communication) and sometimes from one language to another (cross-linguistic mediation). The focus is on the role of language in processes like creating the space and conditions for communicating and/or learning, collaborating to construct new meaning, encouraging others to construct or understand new meaning, and passing on new information in an appropriate form. The context can be social, pedagogic, cultural, linguistic or professional.
MEDIATING A TEXT
The young learner: <i>Relaying specific information in speech or sign</i> - relays (in Language B) simple instructions about places and times (given in Language A), provided these are repeated very slowly and clearly; - relays (in Language B) very basic information (e.g. numbers and prices) from short, simple, illustrated texts (in Language A).

Relaying specific information in writing

- lists (in Language B) names, numbers, prices and very simple information from texts (in Language A) that are of immediate interest, that are composed in very simple language and contain illustrations;

5.4 Strategji komunikimi

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikimi. Strategjitë që përdor nxënësi gjatë komunikimit konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato (veprimtaritë komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

Tabela 11. Strategji që përdor nxënësi, të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënësit

<i>Reception Strategies</i>	
Identifying and inferring	The young learner can deduce the meaning of a word from an accompanying picture or icon.
<i>Production Strategies</i>	
Compensating	The young learner can point to something and ask what it is.
<i>Interaction strategies</i>	
Asking for clarification	The young learner can express in a simple way that he/she does not understand.

5.5 Kompetenca shumë gjuhësore dhe shumë kulturore

Programi i gjuhës angleze për klasën e parë inkurajon zhvillimin e kompetencës shumë gjuhësore dhe shumë kulturore, duke e trajtuar njohjen dhe përdorimin e gjuhëve të ndryshme si një pasuri që ndihmon nxënësin të përmirësojë aftësitë komunikuese si në gjuhën amtare, ashtu edhe në gjuhët e huaja. Kjo qasje mbështetet në idenë se përvoja e nxënësit me gjuhët dhe kulturat fillon nga ajo familjare, zgjerohet në gjuhën e komunitetit dhe më pas në gjuhët dhe kulturat e popujve të tjerë si ato të mësuara në shkollë apo të përjetuara në situata të ndryshme të jetës. Në këtë moshë të hershme, nxënësit janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj dallimeve gjuhësore dhe kulturore, dhe krijimi i hapësirave për të njohur e respektuar gjuhët dhe kulturat e tjera ndihmon në formimin e një identiteti të pasur kombëtar dhe ndërkulturor. Kjo kompetencë i ndihmon fëmijët të kuptojnë se gjuha është një mjet për komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët që mund të vijnë nga kultura të ndryshme. Nxënësi nuk i mban këto përvoja të ndara, por ndërton një kompetencë të integruar komunikuese, në të cilën të gjitha njohuritë dhe përvojat gjuhësore bashkëveprojnë dhe kontribuojnë së bashku në formimin gjuhësor të fëmijëve të kësaj moshe. Për shembull, gjatë mësimit të gjuhës angleze, fëmijët mund të ftohen të shkëmbejnë me njëri tjetrin përshtetjet ose fjalë nga gjuhët që fliten në familjet e tyre, duke u ndjerë të vlerësuar dhe të përfshirë. Kjo qasje i ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe të respektojnë diversitetin gjuhësor dhe kulturor, duke i përgatitur ata për të jetuar në një shoqëri të hapur, tolerante dhe në ndryshim. Integrimi i elementeve kulturore në mësimdhënie u ofron nxënësve mundësinë të njihen me këndvështrime të ndryshme, të ndërtojnë ndjeshmëri ndërkulturore dhe të forcojnë identitetin e tyre kulturor, duke u rritur si qytetarë të vetëdijshëm dhe të angazhuar.

Nxënësi reflekton dhe dokumenton në Portofoli Evropian i Gjuhëve (ELP) përvoja të larmishme ndërkulturore të cilat e ndihmojnë në të nxënin e gjuhëve të huaja.

5.6 Qëndrime dhe vlera

Në klasën e parë fëmijët jo vetëm që prezantohen me gjuhën angleze, fjalorin, funksionet dhe strukturat e thjeshta të kësaj gjuhe, por ata gjithashtu prezantohen me qëndrime dhe vlera që ata do t'i formojnë dhe konsolidojnë në vitet në vijim.

Tabela 12. Qëndrime dhe vlera¹

The young learner:

- appreciates other cultures and diversity;
- shows empathy to family, friends and peers;
- loves learning languages;
- cares about people, objects and animals;
- helps at home, tidies up and looks after the environment;
- shares with and helps friends;
- chooses healthy food;
- is on time;
- is kind to family and friends;
- looks after animals and environment;
- is polite, says sorry, says nice things;
- takes turns when speaking.

¹ <https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture/rfcdc-volumes>

5.7 Formimi kulturor dhe ndërkulturor

Mësimi i gjuhës angleze ka si objektiv kryesor sigurimin e komunikimit mes folësve të kulturave ku flitet kjo gjuhë. Pavarësisht këtij funksioni fillestar, i cili është i rëndësishëm, komunikimi ndërgjuhësor ka një dimension më të thellë: njohjen e kulturës dhe historisë që përmbajnë gjuhët e huaja që nxënësi mëson. Ky dimension i mësimi të gjuhës angleze, që lidhet me komunikimin dhe kulturën, hedh bazat në arsimin fillor dhe forcohet në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të lartë.

Në arsimin fillor, nxënësi prezantohet dhe fillon të eksplorojë kulturat e popujve të ndryshëm dhe lidhjet kulturore që kanë gjuhët. Gjuha angleze i mundëson nxënësit të kuptojë një univers të ri, të përballet me kultura të reja dhe të pasurojë njohuritë e tij kulturore. Në orët e mësimi të gjuhës angleze, fëmijët njihen me zakone, festa dhe mënyra jetese nga kultura të ndryshme. Fëmijët marrin pjesë në aktivitete praktike si të kënduarit e këngëve tradicionale, të lexuarit e përrallave nga vende të ndryshme, etj. Këto përvoja ndihmojnë fëmijët të kuptojnë e të krahasojnë kultura të ndryshme si dhe të zhvillojnë aftësinë për të komunikuar hapur, kuptueshëm dhe me respekt ndaj dallimeve kulturore.

5.8 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të nxënimit (RN)

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të nxënimit në veprimtari të ndryshme që kryen nxënësi.

Tabela 13. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve të komunikimit online

EXAMPLE OF USE IN DIFFERENT DOMAINS FOR DESCRIPTORS OF ONLINE INTERACTION		
ONLINE INTERACTION		
<i>Online conversation and discussion</i>		
The young learner posts simple online greetings, using basic formulaic expressions and emoticons.		
Situation (and roles)	Personal	on a social network site
	Public	on a social network site
	Occupational	[not applicable]
	Educational	as a language classroom simulation

Tabela 14. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve të ndërmjetësimit gjuhësor

EXAMPLES OF USE IN DIFFERENT DOMAINS FOR DESCRIPTORS OF MEDIATION ACTIVITIES		
MEDIATION ACTIVITIES		
<i>Mediating a text</i>		
Relaying specific information in speech or sign		
1. The young learner relays (in Language B) very basic information (e.g. numbers and prices) from short, simple, illustrated texts (in Language A).		
Text (and discourse environment)	Personal	the name, address and phone number of a restaurant, restaurant menus including prices and main ingredients
	Public	the name and address of a shop, the prices of goods, timetables, travel itineraries, performance information schedule, seating availability, price, etc.
	Occupational	[not applicable]
	Educational	the location of a school, the cost of a uniform or school supplies, the destination and cost of a school trip, school timetables

Tabela 15. Shembuj të lidhjes së kompetencave të lëndës dhe strategjive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit

Text/title	Strategy	Task	Linguistic Competence	Sociolinguistic Competence	Pragmatic Competence
Inviting a friend to a party	Listening and repeating / Role play	Say “Do you want to come to my party?” and answer	Simple questions (Do you want...?), Yes/No answers	Use of friendly tone with classmates/friends	Using short phrases to invite and accept/refuse politely
All about my friend	Filling in a simple profile / Drawing and speaking	Talk about a friend's name, age, likes	Vocabulary: name, age, likes; simple sentences (She likes cats)	Saying nice things about others, using names politely	Making a very short description of someone in a friendly way

6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

6.1 Qasja e orientuar drejt veprimit (Action-oriented approach)

Metodologjia bazë në mësimdhënien e gjuhës angleze bazohet në qasjen e orientuar drejt veprimit (action-oriented approach) e cila ka në fokus aftësimin e nxënësit për të vepruar dhe shprehur në situata të ndryshme nga jeta reale. Në këtë qasje, nxënësi paraqitet si një pjesëtar i shoqërisë (social agent) duke promovuar së pari autonominë dhe përfshirjen e tij në procesin e të nxënës.

Bazuar në këtë qasje programi i gjuhës angleze nuk është një program linear i strukturave gjuhësore, ose një grupi njohurish dhe funksionesh gjuhësore, por është një program i bazuar në analizën e nevojave të nxënësit, të orientuara drejt detyrave të jetës reale dhe të ndërtuara rreth nocioneve dhe funksioneve gjuhësore të zgjedhura për këtë qëllim. Kjo promovon një perspektivë ku merren në konsideratë aftësitë se çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi. Gjithashtu mësuesi planifikon duke filluar nga nevojat që ka nxënësit për të komunikuar në një botë reale dhe më pas i përshtat ato me rezultatet e të nxënës dhe mënyrën e vlerësimit (backward planning/design).

Kur nxënësi konsiderohet si një pjesëtar i shoqërisë në përdorimin e gjuhës, ai përfshihet në procesin e të nxënës duke njohur më mirë natyrën sociale të gjuhës dhe përdorimin e saj në vend që thjesht të mësojë rreth gjuhës si një lëndë mësimore. Qasja e orientuar drejt veprimit e merr në konsideratë gjithashtu kompetencën shumë gjuhësore dhe shumë kulturave, duke i mundësuar nxënësit të përdorë të gjitha burimet e tij gjuhësore kur është e nevojshme, duke e inkurajuar ata të shohë dhe dallimet midis gjuhëve dhe kulturave.

Metodologjitë e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive të orientuar drejt veprimit.

Mësuesit e gjuhës angleze, duke mos lënë mënjane metodat tradicionale të mësimdhënies, duhet të përdorin gjerësisht metodën komunikuese në mësimdhënie. Qëllimi i kësaj metode është që në orën e mësimit gjuha e përdorur të jetë sa më afër gjuhës që përdoret në jetën e përditshme. Kjo do të thotë që mësuesi duhet t'i mësojë nxënësit jo “si të flasin” por “çfarë të flasin” dhe “kur të flasin”.

1) Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit janë në qendër të procesit të mësimdhënies i cili ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm dhe kanë stile të ndryshme për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të

pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Shembuj të mësimdhënies me në qendër nxënësin përfshijnë lojërat, simulimet, zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve të thjeshta, etj.

2) Të nxënit bashkëveprues

Të nxënit bashkëveprues është një metodë e mësimdhënies dhe të nxënit, ku nxënësit bashkohen për të eksploruar më tej konceptet e mësuara, për të krijuar projekte të ndryshme. Të mësuarit bashkëveprues ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, zhvillon aftësitë sociale të nxënësve, promovon vetëvlerësimin e tyre dhe i bën ata nxënës autonomë.

3) Mësimdhënie e diferencuar

Mësimdhënia e diferencuar ndihmon mësuesit të angazhojnë në orën e mësimi çdo nxënës duke ju përshtatur stilit të tyre specifik të të nxënit. Mësimdhënia e diferencuar ofron një mënyrë për të përmbushur të gjitha nevojat e nxënësve duke i inkurajuar ata të shprehin atë që kanë mësuar në mënyra të ndryshme.

4) Integrimi i aftësive gjuhësore

Të katër aftësitë gjuhësore (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit) duhet të integrohen tërësisht në mësimdhënien dhe të nxënit e gjuhës së huaj. Kjo metodologji holistike pasqyron natyrën komplekse të përdorimit të gjuhës në jetën reale dhe i përgatit më mirë nxënësit për komunikim efektiv në kontekste të ndryshme.

5) Përdorimi i teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale (IA)

Kjo metodologji përdor teknologjinë dhe inteligjencën artificiale për të krijuar përvoja të personalizuar dhe ndërvepruese të të nxënit. Përfshirja e teknologjisë dhe IA në metodologjitë e mësimi të gjuhës së huaj ofron një përvojë dinamike, të personalizuar dhe tërheqëse dhe përgatit më mirë nxënësit për komunikim në botën reale në gjuhën e huaj që po mësojnë.

6) Të nxënit bazuar në projekt

Të nxënit bazuar në projekt përfshin një qasje dinamike në klasë dhe një metodë mësimdhënieje përmes së cilës nxënësit fitojnë njohuri më të thellë duke eksploruar aktivisht sfidat dhe problemet e botës reale. Të nxënit bazuar në projekt krijon praktika të reja mësimore, të cilat pasqyrojnë mjedisin aktual ku nxënësit jetojnë dhe mësojnë, vendos kërkesa të reja për nxënësit dhe mësuesit për të sfiduar praktikat tradicionale në mësimin e gjuhëve të huaja.

7) Të nxënit nëpërmjet lojës dhe këngës

Të nxënit nëpërmjet lojës dhe këngës është një metodë e përshtatshme dhe efektive, pasi i angazhon fëmijët në mënyrë aktive, duke e kthyer procesin mësimor në një përvojë të këndshme dhe të paharrueshme. Lojërat edukative – si ato digjitale, lojërat tavoline apo garat në grup – ndihmojnë në përforcimin e njohurive përmes argëtimit dhe bashkëpunimit. Po ashtu, lojërat me role dhe simulimet i lejojnë nxënësit të futen në situata konkrete, duke interpretuar personazhe apo skenarë që lidhen me tema nga jeta e përditshme, historia apo shkenca. Këngët në gjuhën e huaj, të shoqëruara me lëvizje apo ritme të thjeshta, ndihmojnë në zhvillimin e gjuhës përmes përsëritjes së natyrshme, duke përmirësuar shqiptimin dhe duke pasuruar fjalorin.

8) Të nxënit bazuar në detyra

Mësuesi organizon mësimin rreth detyrave që nxënësit kryejnë duke përdorur gjuhën e huaj që po mësojnë. Këto detyra imitojnë aktivitetet e botës reale dhe kërkojnë që nxënësit të përdorin komunikim autentik. Fokusi është në arritjen e rezultateve të të nxënit përmes përdorimit të gjuhës, gjë që i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore në mënyrë natyrale.

9) Të nxënit social dhe emocional

Kjo metodologji gërsheton parimet e të nxënit social dhe emocional (vetëdija, vetë-menaxhimi, ndërgjegjësimi social, aftësitë e marrëdhënieve dhe vendimmarrja e përgjegjshme) në të nxënit e gjuhëve të huaja, duke theksuar zhvillimin e inteligjencës emocionale të nxënësve krahas aftësive

gjuhësore. Mësuesit krijojnë një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës ku nxënësit ndihen të sigurt kur përballen me, duke shprehur ndjenjat e tyre dhe duke mbështetur njëri-tjetrin.

10) Qëndrueshmëria mjedisore

Kjo metodologji i inkurajuar nxënësit të ndër veprojnë me mjedisin e tyre dhe ta përdorin gjuhën në mënyra autentike dhe kuptimplote. Përfshirja në orën e mësimit të ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të tjera globale me të cilat po përballlet shoqëria e bën mësimin e gjuhës së huaj më tërheqës, praktik dhe efektiv. Qëndrueshmëria mjedisore mund të integrohet në mësimin e gjuhës angleze në klasë të parë përmes këngëve, tregimeve apo lojërave që lidhen me mbrojtjen e natyrës dhe riciklimin. fëmijët mësojnë fjalë të thjeshta si tree, water, recycle, dhe zhvillojnë ndjeshmëri ndaj mjedisit përmes aktiviteteve të thjeshta e praktike.

11) Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI)

Edukimi për median dhe informacionin është një metodologji që ndërthur mësimin e aftësive gjuhësore me zhvillimin e të menduarit kritik, vlerësimin e informacionit dhe konsumin e përgjegjshëm të medias. Integrimi i EMI në mësimdhënien e gjuhës së huaj krijon një mjedis mësimor dinamik që përgatit nxënësit për komunikim efektiv dhe pjesëmarrje aktive në shoqërinë e një epoke digjitale. Në klasën e parë, mësuesi përmes përdor imazhe, video të thjeshta apo tregime të animuara që ndihmojnë fëmijët të kuptojnë burime të ndryshme informacioni. Fëmijët mund të mësojnë të bëjnë dallimin mes informacionit të vërtetë dhe jo të vërtetë, duke përdorur fjalë të thjeshta në anglisht si “real” dhe “not real”.

12) Integrimi i qasjes STEAM (Science, Technology, Engineering, the Arts and Mathematics)

Nxënësi harton projekte ose detyra duke vënë në përdorim njohuritë e marra në matematikë, në lëndët shkencore dhe në art. Kjo qasje ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e shekullit 21 si bashkëpunimi, krijimtaria, dhe të menduarit kritik.

6.2 Roli i situatave praktike në lëndën e gjuhës angleze

Një ndër mënyrat më efektive për të ndërtuar kuptim të qëndrueshëm dhe të thelluar të njohurive dhe koncepteve gjuhësore në arsimin fillor është përfshirja e situatave reale dhe praktike në procesin e të nxënës. Situatat e të nxënës në lëndën e gjuhës angleze mund të zgjasin një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij. Mësimi nëpërmjet situatave reale, si biseda në dyqan, diskutime në klube, ose aktivitete shoqërore, i bën nxënësit të ndihen më të angazhuar dhe të motivuar në orën e mësimit. Duke u përfshirë në situata nga jeta reale nxënësit përmirësojnë aftësinë e të dëgjuarit dhe të folurit. Përballja me sfida reale i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre të mendimit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, duke i përgatitur ata më mirë për situata të ndryshme në jetë. Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- kompetencat e duhura;
- aftësinë për t'i përdorur këto kompetenca;
- aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

6.3 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës angleze

Projektet kurrikulare përbëjnë një komponent të rëndësishëm të procesit mësimor në lëndën e gjuhës angleze në arsimin fillor, pasi ato i japin mundësi nxënësve të zbatojnë njohuritë e fituara në mënyrë të pavarur, funksionale dhe krijuese, përtej detyrave standarde të tekstit shkollor. Projektet kurrikulare inkurajojnë nxënësit të praktikojnë aftësitë gjuhësore dhe të shprehin qartë idetë e tyre. Angazhimi në projekte i motivon nxënësit të jenë aktivë në procesin e të nxënës dhe të bashkëpunojnë me njeri tjetrin duke zhvilluar aftësitë e tyre sociale, mendimin kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu projektet kurrikulare përfshijnë elemente kulturore, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë kulturën e vendeve anglisht folëse dhe të zhvillojnë ndjenjën e respektit për diversitetin kulturor.

Projektet mund të ndërtohen rreth temave që lidhen drejtpërdrejt me jetën e përditshme ku nxënësit zgjidhin probleme reale dhe marrin vendime të përgjegjshme.

Në këtë proces, roli i mësuesit është ai i *udhëheqësit/organizuesit dhe mentorit*, edhe i një modeli pozitiv komunikimi dhe bashkëpunimi duke i ndihmuar nxënësit që:

- të formulojnë pyetje hulumtuese,
- të planifikojnë hapat e punës,
- të mbledhin dhe të analizojnë të dhëna,
- të interpretojnë rezultatet,
- të prezantojnë në mënyrë të qartë përfundimet e tyre.

Projektet gjithashtu ofrojnë mundësi për integrim ndërdisiplinor, duke lidhur gjuhën angleze me matematikën, me diturinë e natyrës, teknologjinë, etj. duke i përgatitur nxënësit për sfida reale që kërkojnë mendim kompleks dhe bashkëpunim.

6.4 Pedagogjia e mësimdhënies së gjuhës angleze në moshë të hershme

Studimet tregojnë se të mësuarit e gjuhës së huaj duhet të fillojë në një moshë sa më të hershme. Për këtë arsye, mësuesit e gjuhës angleze në klasën e parë duhet t'i kushtojnë rëndësi parësore zhvillimit të aftësive të të dëgjuarit dhe të folurit, duke nxitur saktësinë dhe rrjedhshmërinë në komunikim përmes lojës, këngës dhe ndërveprimit aktiv. Mësuesit duhet të krijojnë mundësi që fëmijët të ndërveprojnë natyrshëm në gjuhën e huaj, të zhvillojnë aftësitë e hershme gjuhësore dhe të ndërtojnë një qëndrim pozitiv ndaj të nxënit të gjuhës së huaj. Praktikatat pedagogjike duhet të jenë gjithëpërfshirëse, duke mbështetur zhvillimin kognitiv, socio-emocional, gjuhësor dhe krijues të fëmijëve. Mësuesi luan rolin e lehtësuesit të të nxënit dhe duhet të krijojë një mjedis të sigurt, stimulues dhe të pasur me përvoja ku fëmijët eksplorojnë, eksperimentojnë dhe përvetësojnë gjuhën e huaj në mënyrë të natyrshme dhe kuptimplotë.

Për të përmbushur sa më mirë kërkesat e programit të gjuhës angleze për klasën e parë, mësuesi rekomandohet të përdorë strategji efektive në mënyrë që fëmijët të mësojnë gjuhën përmes eksplorimit, hulumtimit, zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik. Është e rëndësishme që mësuesit të kenë parasysh tre elementët bazë të pedagogjisë së mësimdhënies në fëmijërinë e hershme të cilat janë **loja, ndërveprimi dhe mjedisi**.




Tabela 16. Elementët bazë të pedagogjisë së mësimdhënies në fëmijërinë e hershme

Components of pedagogy in early childhood	Description
Play	Play is central to how young learners learn. Through play, they demonstrate what they are learning, what interests them, and what concerns them. Play is universally regarded as a way for young learners to learn. They love to play and are happy when given the freedom to explore and experiment.
Interaction	Interaction, especially peer interaction, or engaging with other children through play, provides an important context for learning. In this context, young learners observe, imitate, and build on what they observe. They develop social and emotional skills by sharing, solving problems, coordinating with their peers, and creating their own games. Young learners develop social values as they learn to wait for their turn and play games based on rules.
Environment	Young learners are constantly interacting with their environment. They want to touch everything they see. This is how they learn. Through a variety of activities and materials, young learners explore the physical, social, and natural environments. They manipulate objects, ask questions, make predictions, and develop generalizations. The learning environment for young learners should be welcoming, safe, and predictable. It should offer a variety of developmentally appropriate materials for young learners to explore and experiment with independently. All young learners, especially those with special needs, develop self-esteem and self-confidence when they are appreciated, encouraged, and responded to.

Tabela 17. Aktivitete dhe lojëra

<i>Speaking and listening games</i>	
Simon Says	Children practice actions, body parts, and classroom language ("Simon says touch your nose")
Whisper Chain (Chinese Whispers)	Children pass a short sentence in English from ear to ear—great for listening skills.
What's the Sound?	Children play animal or everyday sounds and ask: “Is it a cat? A bus? A dog?”
Pass the Ball	While music plays, children pass a ball. When it stops, the child holding it must say a word or answer a question.
Stand Up If...	Children play "Stand up if you like apples/dogs/blue" – great for vocabulary and comprehension.
<i>Creative activities</i>	
Sing and Move	Teacher uses action songs like If You're Happy and You Know It, The Wheels on the Bus, etc.
Puppet Shows	Children use finger or sock puppets to say simple phrases and mini dialogues.
Story Time with Props	Teacher reads a story with visuals or toys. Kids repeat key words or act it out.
Draw and Tell	Children draw something based on a theme (e.g., “My House”) and describe it using simple phrases.
Make a Mini-Book	Children create little books on topics like “My Family” or “My Pet” with pictures and words.

<i>Vocabulary & word games</i>	
Flashcard Bingo	Teacher uses image or word cards to play bingo with themes like animals, food, or colors. Children listen for English words and mark them on their cards to get a line or full card.
Memory Game (Matching)	Children match pictures with words or two of the same picture to reinforce vocabulary.
Picture Dictation	Teacher describes a simple picture, and children draw what they hear (“Draw a red ball next to the cat”).
Miming	One child acts out a word or action silently using gestures, and the other children try to guess what it is—great for practicing verbs, animals, or daily routines in English.
I Spy	Children play "I spy with my little eye something green..." to teach colors, objects, and shapes.
Vocabulary Hopscotch	Teacher draws a hopscotch with words or pictures. Kids jump and say the word they land on.
Anagrams (finding the words)	Children rearrange letters to form different words.
<i>Role-play and everyday situations</i>	
At the Shop	Children use play money and realia (plastic fruits, toys) for shopping role-plays.
My Classroom	Children pretend to be the teacher, take attendance, or give instructions.
Weather Reporter	Each day, one child says, “Today it is sunny/cloudy/rainy.”

6.5 Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)

Portofoli Evropian të Gjuhëve (PEGJ), i akredituar nga Këshilli i Evropës për t'u përdorur si dokument kurrikular, është hartuar për tre qëllime kryesore:

- a) të mbështesë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësit;
- b) të forcojë ndërgjegjësimin ndërkulturor të nxënësit;
- c) të promovojë pluri lingualizmin.

PEGJ ka dy funksione:

- a. **Raportues**- tregon aftësitë e nxënësit në lidhje me gjuhët e huaja që ai di ose po mëson duke dhënë informacion rreth përvojave dhe shembuj konkretë mbi arritjet e tij në këto gjuhë. Rëndësia e funksionit raportues të PEGJ-it ndryshon sipas moshës së nxënësit.
- b. **Pedagogjik**- PEGJ është hartuar me synimin e bërjes transparente të procesit të të nxënës të gjuhëve, duke ndihmuar nxënësin të zhvillojë kapacitetin për reflektim dhe vetëvlerësim. Ky funksion përkon me synimet e Këshillit të Evropës për forcimin dhe zhvillimin e autonomisë të nxënësit.

Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ) përbëhet nga tri pjesë:

1. *Pasaporta Gjuhësore*
2. *Biografia Gjuhësore*
3. *Dosja*

Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit të cilat nxënësi i përzgjedh bazuar në përshkruesit e Biografisë Gjuhësore tek PEGJ për një aftësi të caktuar (të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit) dhe nivelit përkatës. Detyrat duhet të përfshijnë të gjitha aftësitë e gjuhës (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit).

Duke qenë një dokument kurrikular mësuesi duhet të planifikojë veprimtari të larmishme që nxënësi të punojë me këtë dokument si p.sh.: punë në grup, punë në çift, ushtrime të krijuara nga nxënësit, diskutime etj. (orët e PEGJ planifikohen brenda orëve të projektit).

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës së huaj do të përshkruhen veprimtari praktike për përdorimin e PEGJ në klasë.

6.6 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjuhës angleze

Në mësimin e gjuhës angleze, është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të ndihen të përfshirë. Disa nxënës mund të përballen me sfida që lidhen me të kuptuarit e koncepteve abstrakte, me ritmin e të mësuarit ose me aftësitë për të zbatuar njohuritë. Roli i mësuesit është të ofrojë mbështetje të personalizuar dhe të krijojë mjedise që nxisin zhvillimin e këtyre aftësive, duke përdorur qasje të ndryshme si:

- ofrimi i ushtrimeve të përshtatura dhe graduale që përforcojnë kuptimin bazë të koncepteve gjuhësore;
- përdorimi i mjeteve konkrete, ilustrimeve, skemave, vizualizimeve dhe simulimeve digjitale që ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë gjuhësore me përvojën konkrete;
- organizimi i punës në grupe të vogla ose në çift, duke inkurajuar ndihmën dhe shkëmbimin e ideve mes nxënësve;
- ofrimi i udhëzimeve të qarta dhe strukturimit të pyetjeve që nxisin të menduarit hap pas hapi;
- përdorimi i teknologjisë arsimore (aplikacione, platforma, video mësimore) që ofrojnë mundësi të ndryshme për t'u praktikuar.

6.7 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës angleze

Nxënësit që tregojnë interes të shtuar në lëndën e gjuhës angleze shpesh kanë nevojë për detyra dhe sfida që i ndihmojnë të thellojnë të kuptuarit, të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues, si dhe të zbatojnë njohuritë në mënyrë fleksibël në situata të reja. Mësuesi ka rolin e udhëheqësit dhe motivuesit, duke i inkurajuar këta nxënës të:

- përballen me detyra të hapura, kërkojnë analiza të thelluara, krahasime, përgjithësime, argumentim, etj.;
- krijojnë vetë situata problemore, skenarë ose pyetje që nxisin zgjidhje kreative dhe të argumentuara;
- angazhohen në lojëra logjike, sfida mendore, ose ushtrime që stimulojnë mendimin deduktiv dhe aftësitë analitike;
- krijojnë vjersha të thjeshta ose tregime të ilustruara me figura;
- luajnë rolin e udhëheqësit në punën me grupe ose të ndihmojnë shokët e klasës, duke zhvilluar edhe aftësitë sociale.
- shohin video, filma ose të dëgjojnë tregime të thjeshtë ose audio të nivelit pak më të lartë për të ushtruar të dëgjuarit dhe të kuptuarit.
- inkurajohen të të përdorin fjalët e reja në situata të përditshme, si në shtëpi apo në ambientin shkollor.

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e gjuhës angleze, vlerësimi i nxënësve në arsimin fillor është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i mësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e gjuhës angleze qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet duke reflektuar të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë, si dhe të motivohet për të ecur përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësit i kanë kuptuar koncepte dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies;

7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e gjuhës angleze

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxëni)

Ky lloj vlerësimi bëhet në fillim të vitit shkollor ose të një kapitulli të ri. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- me ushtrime të shkurtra orientuese;
- me kuice të shkurtra;
- me lojëra ose biseda reflektuese,

- fisha vetëvlerësimi, etj.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar në punën e tyre para se të arrijnë vlerësimin përmbledhës ose përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- vlerësimi i punës në grupe;
- vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimit;
- detyrat e përditshme dhe projektet e vogla;
- vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimit;
- vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj.

Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënit)

Vlerësimi përmbledhës për klasën e parë është përshkrues dhe bëhet pas një periudhe mësimore, ose pas një kapitulli dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me detyra individuale me shkrim, projekte përmbyllëse etj.

7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e gjuhës angleze

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë dhe të reflektojnë mbi gabimet e tyre.
- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin aftësitë dhe njohuritë që nxënësit duhet të zhvillojnë sipas kompetencave të gjuhës angleze.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënës.
- Mësuesi duhet të përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigjet me gojë, ushtrimet, punën me materiale konkrete, projektet, vizatimet, punën në grup, detyrat e shtëpisë etj.

Ky proces ndihmon që vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për nota, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen çdo ditë në mësimin e gjuhës angleze.

7.3 Teknika për vlerësimin formues

Në këtë rubrikë paraqiten disa teknika që përdor mësuesi për vlerësimin formues në lëndën e gjuhës angleze në klasën e parë.

Tabela 18. Teknika për vlerësimin formues

Assessment tools/ techniques	Description
Anecdotal records	Brief written notes based on observations of young learners, including how and where they spend time, their social relationships, their use of language, their modes of interaction, and information about their health and nutrition habits.

Portfolios	A portfolio is a flexible collection of various work samples that show different aspects of a young learner's learning over time. This type of assessment focuses on the strengths and demonstrations of knowledge and skills of young learners. Teachers should use European Language Portfolio (ELP) which is designed for very young learners. As a self-assessment tool, the ELP motivates young learners, helps them appreciate their strengths, recognize their weaknesses, and orient their learning more effectively. ELP encourages autonomous learning, giving young learners greater control over their learning and informing them about their learning process.
Observations	Observation can be planned for the purpose of observing young learners in a specific situation. It can also be carried out as an ongoing, natural process during everyday teaching and learning activities. When carried out scientifically, observation is a source of valid information about a young learner's various personality dimensions and learning progress.
Checklist	Checklists are a list of learning outcomes, behaviours, or traits of a young learner in a particular development area. Teacher are to determine whether these traits exist in a young learner or not. They have to mark on the checklist as "Yes" or "No" to indicate whether a particular young learner exhibited a behaviour during that observational period.
Rubrics	A rubric is a tool used to assess performance, skill levels, procedures, processes, qualities, quantities, or end products. Similar to checklists, rubrics indicate the degree of accomplishment rather than just a simple yes or no.
Picture-Based Tasks	Teachers show learners pictures and ask them to name objects, describe scenes with simple vocabulary, or point to specific items based on instructions. This visual approach to language learning is engaging and helps reduce stress while improving comprehension and language production.

Learning Journals (Teacher Assisted)	This is a simple journal in which young learners, with support, can draw or write words or sentences about what they learned or enjoyed. Teachers can use it to assess vocabulary retention, expression, and emotional engagement with content over time.
Games	Teachers can observe learners' listening comprehension, vocabulary use, and spoken responses in an informal context with language games such as Simon Says, Flashcard Bingo, and Matching Pairs.
Story Retelling	After listening to a short story or song, young learners retell the story using pictures or gestures. Teachers then assess their comprehension, sequencing, and recall of basic vocabulary.
Peer Interaction Tasks	Teachers can assess how young learners use language to communicate with peers through paired or group activities, such as "Find someone who..." tasks and pair interviews, which promote both social and linguistic development.
Audio/Video Recording	Short recordings of learners speaking, singing, or reciting rhymes can be used to track improvements in pronunciation, fluency, and language use over time. These samples can also be included in portfolios for reflection or comparison purposes.

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë procesit mësimor të gjuhës angleze, përdorimi i burimeve të ndryshme ndihmon në zhvillimin e aftësive komunikative dhe në kuptimin e thellë të strukturave gjuhësore. Materialet konkrete, vizuale dhe teknologjike krijojnë mundësi që nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive dhe të zbatojnë njohuritë në situata reale. Mësuesi integron mjete të ndryshme për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit dhe i ndihmon ata të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e marra, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorura didaktike janë: tekstet shkollore, fletoret e punës, posterat, flashcards, aplikacionet arsimore (platforma Akelius), burimet multimediale (librat elektronikë interaktiv, kanalet arsimore në YouTube, udhëtimet virtuale në terren), tabelat SMART, lojërat e tavolinës, lojërat me letra ose lojërat edukative, materiale për lojë me role dhe simulim, materiale të përgatitura nga mësuesi, këngët, vjershat, audiobooks dhe podcaste, vizitat në muze, kopshte zoologjike, vende historike, folësit e ftuar, stacionet/këndet mësimore, etj.

Përdorimi i një shumëllojshmërie të këtyre materialeve dhe të burimeve siguron që nxënësit të kenë mundësi të shumta për t'u përfshirë me përmbajtje në formate të ndryshme, duke u kujdesur për stile të ndryshme të të mësuarit (pamor, dëgjimor, kine estetik) dhe duke rritur përvojën e tyre të përgjithshme të nxënies.

Gjatë shpjegimit, mësuesi përdor gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, fjali të shkurtra dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Mësuesi zgjedh shembuj konkretë dhe ushtrime të personalizuar, duke siguruar mbështetje shtesë për nxënësit që kanë nevojë.

8.1 Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore

Në arsimin fillor, përdorimi i teknologjisë në orët e gjuhës angleze është një mundësi shumë e mirë për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësitë e komunikimit, krijimtarisë dhe të kuptojnë lidhjen e gjuhës me kulturën dhe shoqërinë. Qasja ndërvepruese, e cila përfshin përdorimin e platformave digjitale, aplikacioneve dhe burimeve multimediale, inkurajon nxënësit të angazhohen dhe të eksplorojnë tema të ndryshme në mënyrë

krijuese. Klasat e pajisura me mjete si tabela interaktive dhe burime online ndihmojnë në krijimin e një mjedisi mësimor motivues, ku gjuha mësohet në një kontekst dinamik dhe praktik, duke i përgatitur nxënësit për sfida të ndryshme të komunikimit në botën reale. Më poshtë listohen disa mënyra për përdorimin e teknologjisë në lëndën e gjuhës angleze.

- Përdorimi i tabelave interaktive për zhvillimin e lojërave gjuhësore, ushtrimeve me imazhe dhe këngëve në anglisht që fëmijët mund të ndjekin dhe t'i ndihmojnë në përvetësimin e fjalëve të reja.
- Shikimi i videove të shkurtra edukative, këngëve dhe tregimeve në platforma si YouTube Kids apo materiale të zgjedhura nga mësuesi, për të forcuar aftësinë e të dëgjuarit dhe të kuptuarin e gjuhës.
- Përdorimi i aplikacioneve të thjeshta dhe të sigurta për fëmijë (si p.sh. Akelius2) për të ushtruar fjalorin dhe frazat përmes lojës dhe ndërveprimit.
- Luajtja e lojërave edukative gjuhësore në pajisje digjitale, si tabletë apo kompjuter, të cilat ndihmojnë në mësimin e fjalëve për ngjyrat, numrat, kafshët etj.
- Përdorimi i materialeve audio dhe podkasteve për fëmijë për të dëgjuar gjuhën angleze në mënyrë të natyrshme dhe argëtuese, edhe jashtë mjedisit të klasës.
- Krijimi i aktiviteteve interaktive në platforma të thjeshta për mësues, ku mund të përgatiten ushtrime (drag-and-drop), përputhje fjalësh me figura, apo mini-kuize për rishikimin e mësimin.
- Etj.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës angleze do të përshkruhen përdorimi i burimeve dhe materialeve didaktike përfshirë teknologjinë.

² <https://languages.akelius.com/>

9 ANALIZA SASIORE E PROGRAMIT TË GJUHËS ANGLEZE NË KLASË TË PARË

<i>Klasa I</i>	<i>Përmbajtja e gjuhës angleze</i>	100%
	<i>Formimi kulturor dhe ndërkulturor</i>	35%
	<i>Gramatikë</i>	5%
	<i>Formimi gjuhësor</i>	50%
	<i>Projekti dhe puna me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ)</i>	10%

<i>Klasa I</i>	<i>Zhvillimi i kompetencave</i>	100%
	<i>Kompetenca gjuhësore</i>	85%
	<i>Kompetenca sociogjuhësore</i>	5%
	<i>Kompetenca pragmatike</i>	10%

Ndarja e kohës mësimore për zhvillimin dhe forcimin e kompetencave të lëndës së gjuhës angleze e ndihmon mësuesin të strukturojë përmbajtjen mësimore, të hartojë rezultate të nxëni të matshme dhe të arritshme për moshën dhe nivelin gjuhësor të nxënësve, si dhe të zhvillojë aktivitete në orën e mësimit që fuqizojnë kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj. Në këtë fazë fillestare të të nxënësit të gjuhës angleze, 85% e kohës mësimore i kushtohet zhvillimit të **kompetencës gjuhësore**, pasi theksi kryesor vendoset në krijimin e bazave të forta gjuhësore përmes mësimit të fjalorit, shqiptimit të saktë dhe njohjes së strukturave të thjeshta gjuhësore. Nxënësi mëson të kuptojë dhe të përdorë shprehje të thjeshta, të dëgjojë me vëmendje dhe të fillojë të ndërtojë fjali të shkurtra. Aktivitete që kanë të bëjnë me krijimin e **kompetencës pragmatike** (10%) përfshihen në këtë klasë për të inkurajuar përdorimin e gjuhës në situata të thjeshta komunikimi si përshëndetjet, bërja e kërkesave të thjeshta apo prezantimeve

të vetes ose pjesëtarëve të familjes. **Kompetenca sociogjuhësore** (5%) fokusohet në ndërveprime të thjeshta dhe të strukturuar, duke ndihmuar fëmijët të fillojnë të ndërtojnë vetëbesim në përdorimin e gjuhës në mjedise sociale dhe kulturore të njohura. Kjo ndarje ndihmon në krijimin e një ambienti të sigurt dhe mbështetës për fëmijët për të nxitur të folurin dhe dëgjimin aktiv në gjuhën angleze që në hapat e parë të të nxënës.

Klasa I	Veprimtari gjuhësore	100%
	Veprimtari që zhvillon nxënësi për të marrë informacion <i>(Të dëgjuarit dhe të lexuarit)</i>	55%
	Veprimtari që zhvillon nxënësi për të prodhuar informacion. <i>(Të folurit dhe të shkruarit)</i>	5%
	Veprimtari që zhvillon nxënësi kur ndërvepron me të tjerët <i>(Të folurit dhe të shkruarit)</i>	40%
	Veprimtari që zhvillon nxënësi për të analizuar/ interpretuar/sintetizuar informacionin <i>(Ndërmjetësimi gjuhësor- Të folurit dhe të shkruarit)</i>	0%

Veprimtaritë gjuhësore të shprehura në formën e rezultateve të të nxënës ndihmojnë mësuesin të planifikojë lloje të ndryshme aktiviteteve që zhvillojnë aftësi gjuhësore të balancuara dhe të orientuara drejt përdorimit të gjuhës në situata nga jeta reale për të arritur këto rezultate. Veprimtaritë gjuhësore të planifikuara në këtë fazë fillestare të mësimin të gjuhës angleze kanë si qëllim që nxënësi të njohë gjuhën angleze nëpërmjet dëgjimit të këngëve, dialogjeve të shkurtër, ndërveprimit të thjeshtë dhe imitimit të modeleve gjuhësore. Në klasat I dhe II, marrja e informacionit (55%) zë peshën më të madhe në veprimtaritë që organizon mësuesi, pasi është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë të kuptojnë fjalë dhe shprehje të njohura përmes dëgjimit të tregimeve, këngëve, udhëzimeve dhe situatave të përditshme. Mësuesi gjithashtu planifikon dhe organizon veprimtari ndërvepruese (40%) duke lejuar fëmijët të praktikojnë të folurit përmes lojës me role, pyetje përgjigje të thjeshta dhe përshëndetjeve, me qëllim rritjen dhe forcimin e vetëbesimit të fëmijëve për të përdorur gjuhën angleze në mënyrë spontane. Mësuesi përfshin veprimtari shumë të thjeshta ku fëmijët prodhojnë informacion (5%) si përsëritje fjalësh, emërtim objektsh apo krijim i fjalive të shkurtra. Në këtë fazë, ndërmjetësimi gjuhësor nuk parashikohet akoma si veprimtari, pasi ai përfshin aftësi përpunuese që zhvillohen në klasat më lart.

10 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së gjuhës angleze bazohet në Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Planin Mësimor të Arsimit Fillor si dhe në Kuadrin e Përbashkët Evropian për Gjuhët dhe Volumin Shoqërues³ (2020). Si i tillë ky dokument i shërben mësuesve, autorëve të teksteve mësimore, hartuesve të testeve kombëtare, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë kapitull përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit në mënyrë që të maksimizohet efektiviteti i programit të lëndës së gjuhës angleze.

a) Rekomandime për mësuesit

- Të lidhin përmbajtjen e gjuhës angleze me fusha të tjera (dituri natyre, matematikë, art, gjuhë shqipe, edukatë qytetare, etj.) për të ndihmuar në zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve.
- Të përdorin situata nga jeta reale, si role-play, lojëra, dhe projekte që lidhen me interesat e nxënësve për të rritur angazhimin e tyre në procesin mësimor.
- Të inkurajojnë nxënësit të eksplorojnë tema të ndryshme në mënyrë të pavarur përmes kërkimeve dhe prezantimeve, duke u dhënë atyre mundësinë të zhvillojnë aftësi kërkimore dhe prezantuese.
- Të planifikojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë rëndësinë e gjuhës angleze në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- Të shfrytëzojnë mjetet digjitale dhe platformat online për të krijuar një mjedis më interaktiv, duke përdorur video, podcast dhe burime të tjera për përparimin e nxënësve.

³ <https://rm.coe.int/common-european-framework-of-reference-for-languages-learning-teaching/16809ea0d4>

- Të fokusohen në zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, përmes projekteve ndër lëndore.
- Të inkurajojnë nxënësit të eksplorojnë kulturën e vendeve anglisht folësë duke përdorur, muzikë, filma dhe aktivitete kulturore, për të rritur ndjeshmërinë kulturore.
- Të organizojnë ditën evropiane të gjuhëve si një manifestim i shumë gjuhësisë dhe shumë kulturave.
- Të japin feedback të vazhdueshëm dhe konstruktiv për të ndihmuar nxënësit të përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore dhe të kuptojnë më mirë boshllëqet e tyre.
- Të inkurajojnë nxënësit të zhvillojnë projekte që përfshijnë përdorimin e gjuhës angleze në mënyrë krijuese.
- Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me talente.
- Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio emocional.
- Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- *Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të lëndës së gjuhës angleze (p.sh. sugjerohet 30% teori — 70% praktikë). Përdorimi praktik i gjuhës angleze do të realizohet jo vetëm në orët e veçanta si: ushtrime, përsëritje, projekte, konkurse etj, por përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.*
- Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së gjuhës së huaj.
- Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e gjuhës angleze në tekstet shkollore.

- Të sigurojnë librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së tekstit shkollor.
- Të sigurojnë materialet burimore edhe digjitale për zbatimin e tekstit shkollor.
- Të përfshijnë në tekstet shkollore ushtrime që promovojnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve, krijimtarinë, lojëra argëtuese, këngë, etj.
- Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën, duke marrë parasysh diversitetin kulturor dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve.
- T'i referohen Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe Volumit Shoqërues për hartimin e teksteve sipas niveleve të përcaktuara për secilën klasë.

c) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve gjuhësore.
- Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- Të vlerësojnë balancën midis kohës që flet mësuesi dhe kohës që flasin nxënësit.
- Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e gjuhës angleze.
- Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

d) Rekomandime për prindërit

- Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e gjuhës angleze jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte të lidhura me gjuhën angleze.
- Të promovojnë një qëndrim pozitiv ndaj mësimi të gjuhës angleze, duke theksuar rëndësinë e përpjekjes dhe të mësimi nga gabimet.
- Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i gjuhës angleze zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.
- Të inkurajojnë përdorimin e gjuhës angleze jashtë shkollës përmes leximit të librave, shikimit të filmave, dëgjimit të muzikës apo përdorimit të aplikacioneve edukative, etj.

e) Rekomandime për nxënësit

- Të marrin pjesë aktive në orët e mësimi të gjuhës angleze, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive.
- Të angazhohen në lojëra dhe projekte kurrikulare që lidhin gjuhën angleze me lëndët e tjera.
- Të bashkëpunojnë me shokët dhe të mësojnë të komunikojnë lirshëm në gjuhën angleze si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- Të kuptojnë rëndësinë e gjuhës angleze si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

11 NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE

Në lëndën e gjuhës angleze së klasës së parë ka këto ndryshime përmbajtjesore:

- 1) Reflektim i ndryshimeve të bëra në Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët, Volumi Shoqërues, 2020. ⁴
- 2) Vendosja e fokusit në qasjen e orientuar drejt veprimit duke sugjeruar një ndarje brenda orës së mësimi 30% pjesa teorike dhe 70% pjesa praktike. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- 3) Përditësimi i kompetencave kyç dhe i rezultateve të të nxënëtit të përshtatura për klasën e parë.
- 4) Përditësimi i kompetencave të lëndës dhe i rezultateve të të nxënëtit.
- 5) Riorganizimi dhe përshkrimi në gjuhën angleze i njohurive gjuhësore, gramatikore dhe funksioneve gjuhësore.
- 6) Përditësimi i rezultateve të të nxënëtit duke shtuar komunikimin online dhe ndërmjetësimin gjuhësor dhe kulturor.
- 7) Riorganizimi i veprimtarive gjuhësore dhe strategjive në formën e rezultateve të të nxënëtit.
- 8) Promovimi i shumë gjuhësisë dhe shumë kulturave.
- 9) Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
- 10) Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, edukimin për median dhe informacionin, qëndrueshmërinë mjedisore, të nxënëtit e personalizuar, të nxënëtit social emocional, përdorimin e teknologjisë dhe IA etj.
- 11) Përditësimi i vlerësimit të nxënëtit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënëtit.
- 12) Shembuj teknikash për vlerësimin formues.

⁴ Council of Europe (2020), *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment – Companion volume*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, available at www.coe.int/lang-cefr

12 TABELA E NIVELEVE SIPAS KLASAVE

Tabela pasqyron përputhjen e niveleve gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe shtrirjen e tyre sipas klasave në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë për gjuhën angleze.

Nivelet Klasat	Pre A1	A1	A2	A2+	B1	B1+	B2
Klasa 12							
Klasa 11							
Klasa 10							
Klasa 9							
Klasa 8							
Klasa 7							
Klasa 6							
Klasa 5							
Klasa 4							
Klasa 3							
Klasa 2							
Klasa 1							